

UDHËZIM PËR VLERËSIM

SHËNIM: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 1 - 2006

DETYRA 2: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Qendra Rajonale për Mjedisit Jetësor për Evropën Qendrore dhe Evropën Lindore/Qendra Rajonale e Mjedisit Jetësor*

DETYRA 3: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *nga pambuku, kallami, argjendi, lëkura.*

DETYRA 4: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar JO dhe ka shkruar: *Ekspozuesit kanë qenë nga Shqipëria dhe Mali i Zi,/Ata kanë qenë vizitorët e panairit./Panairi është organizuar në Shkodër dhe ka tubuar rreth 50 ekspozues nga rajoni i Liqenit të Shkodrës (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Shënim:

1. Nxënësi merr 1 pikë nëse ka argumentuar saktë, por nuk ka rrethuar as PO dhe as JO.
2. Nxënësi merr 0 pikë nëse ka rrethuar Po, pa marrë parasysh saktësinë e argumentimit.

DETYRA 5: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përshkruar ose perifrashuar fjalinë nga teksti e që ka të bëjë me qëllimin: **Qëllimi** ka qenë që të promovohen prodhimet e kultivuara në rajonin e Liqenit të Shkodrës./Qëllimi i panairit ka qenë që të promovohen prodhimet e kultivuara në rajonin e Liqenit të Shkodrës, si një potencial i madh i popullatës vendore në zhvillimin e këtij rajoni.

DETYRA 6: gjithsej **2 pikë**:

A) Bashkëtingëlloret grykore: K, H, G.

(1 pikë)

B) Bashkëtingëlloret dybuzore: P, M, B.

(1 pikë)

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2022-2023

DETYRA 7: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Tiranë – as = *tiranas*
Tivar – as = *tivaras*

DETYRA 8: gjithsej **2 pikë**:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Rudyard Kipling*
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Në formën e këshillimeve*

DETYRA 9: gjithsej **3 pikë**:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Autori vë theksin tek forca për të përballuar sfidat e pashmangshme të jetës.*
- B) nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar:
Rima: *Rimë e alternuar 1 pikë*
Shembulli: *Ka përshkruar strofën e parë ose ndonjë strofë tjetër ku kemi rimë të alternuar 1 pikë*

DETYRA 10: është rrethuar numri 3- të birit
1 pikë

DETYRA 11: gjithsej **2 pikë**:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Në vetën e dytë*
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar përgjigjen nën A me vargje nga poema: *Në mund të ruash arsyen; në mund të rrish në pritje... etj.*

DETYRA 12: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. *Futbollistët stërvitën shumë.*
1 pikë
2. *Shitorja ishte plot mallra.*
1 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2022-2023

DETYRA 13: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 2- kg. (kilogram)
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar fjalën **bukur** e cila nuk i përket vargut të dhënë të klasës së fjalëve.

DETYRA 14: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Gjinisë dramatike*

DETYRA 15: është rrethuar numri 1- besën
1 pikë

DETYRA 16: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Arsyeja e parë: *populli*

1 pikë

Arsyeja e dytë: *vetja*

1 pikë

DETYRA 17: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Nita mishëron tiparet më të larta dhe më të bukura të vajzës shqiptare*

DETYRA 18: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Bashkëfolësi i Nitës është Zefi.*

B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Nita i drejtohet diellit.*

DETYRA 19: gjithsej **3 pikë:** Nxënësi merr nga **1 pikë** për karakteristikat e sakta të secilit emër.

EMRI	GJINIA	NUMRI	RASA	LAKIMI
mendimet	<i>femërore</i>	<i>shumës</i>	<i>emërore</i>	<i>I</i>
e darkës	<i>femërore</i>	<i>njëjës</i>	<i>gjinore</i>	<i>III</i>
njeriut	<i>mashkullore</i>	<i>njëjës</i>	<i>dhanore</i>	<i>II</i>

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2022-2023

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit *Personazhi im i preferuar letrar*

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan se dëshiron (apo nuk) dëshiron të lexojë vepra letrare dhe shkurtimisht e argumenton përgjigjen.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan titullin e veprës së preferuar.

Gjithsej 1 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për veprën letrare që preferon ai.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përmend personazhin (ose personazhet) nga vepra letrare e preferuar.

Për një shpjegim/përshkrim më të plotë merr 2 pikë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 3 pikë.

Gjithsej 3 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përmend përse shokët apo shoqet e tij duhet ta lexojnë atë vepër letrare.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2022-2023

Nëse shkruan në mënyrë të argumentuar, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur</p> <p>2 pikë</p>	<p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës)</p> <p>2 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p> <p><i>Gjithsej 4 pikë</i></p> <p><u>GRAMATIKA</u></p>	<p>→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>1 pikë</p> <p>→ s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>0 pikë</p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike</p> <p>1 pikë</p>
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve</p> <p>pjesërisht e saktë</p> <p>1 pikë</p>			

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2022-2023

	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë <i>Gjithsej 2 pikë</i></p>		
--	---	--	--